

VENDIM
Nr. 338, datë 19.3.2008

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(Ndryshuar me VKM nr. 1695, datë 24.12.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 628, datë 3.10.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË NË ZBATIM TË VKM NR.201, DATË 29.3.2006
(VERSIONI SIPAS PIKËS 4.1)

1. Projektakti synon të transpozojë dispozitat e legjislacionit të BE-së të evidentuara, si të detyrueshme në Direktivën 2003/54/EC botuar në Fletoren Zyrtare. Ai ekzekuton dispozitat e direktivës së sipërcituar përsa i takon përcaktimit të rregullave të funksionimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike”				
2-Për miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike				
3-Përafrim i pjesshëm i Direktivës 2003/54 (KE), nëpërmjet transpozimit të përmbajtjes së parimeve dhe neneve të kësaj directive				
a	b	c	d	e
Në direktivën 2003/54	1.Në Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, pjesë e projektvendimit “Për miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike	Përafrim i pjesshëm		
Neni 8 dhe neni 9, Qëllimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe detyrat që kryen përcakton detyrat e OST ku jep se ky operator duhet të kryejë transmetimin e energjisë elektrike, përputhjen	4.1 OST-ja është shoqëri e pavarur shtetërore që kryen këto funksione: operimin e rrjetit nga pikëpamja fizike (posedim, mirëmbajtje dhe zgjerim) (ORT); Operatorin e Sistemit nga pikëpamja e dispeçerimit (OS);			

e kërkesës me furnizimin, menaxhimin e flukseve të energjisë, pra dispeçimin e tyre, si dhe operatorin e tregut, si dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit. Neni 2, pika 8, jepet definicioni për Furnizuesit me shumicë. Neni 13-Qëllimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që përcakton se OSSH është përgjegjës për shpërndarjen e energjisë elektrike, të sigurojë mirëmbajtjen e rrjetit që disponon, zhvillon dhe mirëmban rrjetin shpërndarës. Neni 23, pika 1 Autoriteti Rregullator Që përcakton se ai është një strukturë e pavarur nga interesat e industrisë elektrike dhe është përgjegjës për funksionimin e tregut duke siguruar jo diskriminimin , efektivitetin dhe kompeticion	Operatorin e Tregut (duke siguruar që informacioni për likuidimin e kontratave është i disponueshëm, që më pas mund të shërbejë si një bursë e energjisë elektrike). 4.7 Furnizuesi Publik me Shumicë ka përgjegjësi për blerjen e energjisë elektrike për furnizimin pa ndërprerje të klientëve tariforë. Furnizuesi Publik ka përgjegjësinë si furnizues publik që të shërbejë si sigures i alternativës së fundi për të gjithë klientët. 4.7 Furnizuesi Publik me Shumicë ka përgjegjësi për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar furnizim të majftueshëm për Furnizuesin Publik me Pakicë sipas kërkesës së këtij të fundit për furnizimin pa ndërprerje të Klientëve Tariforë. 4.8 OSSH-ja zotëron, mirëmban,zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes në të gjithë Shqipërinë. OSSH-ja do të përdorë të njëjtën metodologji për të llogaritur tarifën e përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes që ajo përdor për llogaritjen e tarifave për klientët tariforë. OSSH/Furnizuesi Publik do t’ia propozojë të ndarë ERE-s tarifën e shërbimit të shpërndarjes nga tarifat e furnizimit të klientëve tariforë. 4.12-Rregullatori i Pavarur (ERE) ERE-ja është përgjegjëse: a)për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve respektive të pjesëmarrësve të tregut sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jo diskriminuese që sigurojnë aksesin e palëve të treta; (Që është në vartësi të Kuvendit përcaktohet në ligjin nr.9072, datë		
--	--	--	--

Neni 9 (a) Detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ku përcaktohet se: OST siguron aftësinë e sistemit për të mbajtur kapacitetet e sistemit të transmetimit në përputhje me kërkesën afatgjatë Neni 12- Konfidencialiteti në Operatorin e Sistemit të Transmetimit përcakton se OST duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit dhe të punojë në mënyrë jodiskriminuese Neni 11-Dispecimi dhe balancimi përcakton se furnizmi elektricitetit bëhet në bazë të detyrimeve kontraktuale OST ka detyrë të kryejë dispecimin e instalimeve gjeneruese dhe të përdorë interkonjeksionin sipas kriterëve të përcaktuara Neni 9 (c) te detyrat e OST përcaktohet se OST ka detyrë të menaxhojë flukset e energjisë në sistem duke llogaritur dhe shkëmbimet me interkonjeksionin është përgjegjës për të garantuar siguri të furnizimit dhe Neni 23.2 (a) Autoriteti Rregullator. Përcakton se ai është përgjegjës për përcaktimin e metodologjisë	22.5.2003 “Për sektorin e Energjisë elektrike”. 5.1 Parashikimi afatgjatë OST-ja ka për detyrë të përgatisë parashikime 15-vjeçare për nevojat e vendit për energji elektrike OST-ja është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit të siguruar nga pjesëtarët e tregut në ato raste kur nxjerrja e tij dëmton konkurrencën. 5.2 Kontrata e furnizimit të një viti në avancë Marrëdhëniet dhe roli i pjesëmarrësve të tregut me operimin fizik të Modelit të Tregut bazohet në kontrata dypalëshe mes pjesëmarrësve të ndryshëm në përputhje me përcaktimet e mëposhtme. OST-ja blen nëpërmjet kontratës së shërbimeve ndihmëse, shërbimet që i nevojiten sistemit në përputhje me parashikimet që i dërgohen asaj nga OSSH-ja, furnizuesi publik dhe Klientët e Kualifikuar. OST-ja ka përgjegjësinë të dispecerojë të gjitha njësitë në zotërim të KESH Gen-it, të PPE-ve, Tregtuesve dhe Furnizuesve të Kualifikuar dhe të respektojë të gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara në rregullat e tregut 5.6 OST-ja do të krahasojë shumën e parashikimeve të ngarkesës të marrë nga pjesëtarët e tregut me parashikimet e saj dhe të vendosë së çfarë hapash të mëtejshëm (p.sh. blerje mund të jenë të nevojshme për të balancuar sistemin	
---	--	--

dhe tarifave në rrjetin nacional Tarifat dhe metodologjitë duhet të lejojnë investimet e nevojshme për të garantuar punë të sigurt të rrjetit Neni 23.1 Autoriteti Rregullator Që përcakton se ai është një strukturë e pavarur nga interesat e industrisë elektrike dhe është përgjegjës për funksionimin e tregut duke siguruar jo diskriminimin efektivitetit dhe kompeticionin Neni 20. Aksesit i Palëve të Treta përcakton se duhet siguruar aksesit i Palëve të Treta në transmetim në mënyrë jodiskriminuese Neni 23 b Përcakton se duhet të ketë mekanizma në rastet e transmetimeve të ngarkesave shumë të mëdha dhe të linjave të mbingarkuara Neni 23.1.d përcakton se duhet të publikohen informacione lidhur me kapacitetet në transmetim dhe shpërndarje, por pa shkelur parimet e konfidencialitetit Neni 11-Dispeçimi dhe balancimi përcakton se furnizimi i elektricitetit bëhet në bazë të detyrimeve kontaktuale 23.2.b Përcakton se duhet të parashikohet shërbimi i blancimit dhe 23.3 përcakton	7.Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i siguron shërbimin e shpërndarjes klientëve të kualifikuar sipas tarifave të përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes të miratuara nga ERE-ja. 8.Roli i Rregullatorit të Pavarur ERE ERE-ja e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” me të gjitha ndryshimet. Funksionimi i rregullatorit të pavarur përmbush kërkesat e Direktivës së BE-së 2003/54 8.b-Aksesit i Palëve të Treta. Prioriteti në sistemin e transmetimit ose e menaxhimit të bllokimeve kur linjat e transmetimit janë të kufizuara dhe nuk mund t’i përballojnë të gjitha kërkesat e Klientëve Tariforë dhe atyre të Kualifikuar. Një çështje tjetër që duhet trajtuar në Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut është ajo se si do të ndahet mungesa e kapaciteteve mes Klientëve Tariforë dhe Klientëve të Kualifikuar në mënyrë që të zbatohet nga OST-ja. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimet e aksesit të hapur dhe jodiskriminues. 8.d Në mënyrë që tregu të arrijë objektivat e tij, ERE-ja dhe në shumë raste OST-ja, duhet të kenë akses të mjaftueshëm në informacionin lidhur me operimet, kostot, si dhe termat dhe kushtet e kontratave ndërmjet palëve. 8.h. Shërbimi i Disbalancës së Energjisë sigurohet kur ka një diferencë ndërmjet sasisë së prodhimit që është programuar një ditë më parë ose që është prodhuar në kohë reale dhe të konsumit (ngarkesës) në kohë reale.	
---	--	--

se duhet të përcaktohen rregulla, metodologji dhe tarifa për këtë qëllim				
--	--	--	--	--

MODELI SHQIPTAR I TREGUT

HYRJE

Miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, perben nje nga hapat e rendesishem drejt konsolidimit dhe zhvillimit te qëndrueshëm te Tregut të Energjisë Elektrike ne Shqiperi.

Ky miratim është pjesë e reformës qe ka ndërmarrë Qeveria Shqiptare per ristrukturimin e gjithë sektorit elektroenergjetik, mbështetur ne ligjin per sektorin e energjisë elektrike, si dhe ne politikat e Qeverise per zhvillimin e ketij sektori.

Gjithashtu, Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike është hartuar ne zbatim te Direktivave te Bashkimit European per energjine elektrike, si dhe te kerkesave te Traktatit te Komunitetit te Energjisë te vendeve te Europes Juglindore, per krijimin e Tregut Rajonal te Energjisë Elektrike, dokument ky i ratifikuar nga Kuvendi i Shqiperise ne vitin 2006.

Struktura e mëparshme e quajtur Modeli Tranzitor i Tregut të Energjisë Elektrike gjate procesit te zbatimit ne praktikë, evidentoi nevojën e përditësimit te tij, ne funksion te zhvillimeve qe lidhen me thellimin e reformës ne sektorin elektroenergjetik shqiptar te ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare.

Struktura e re e quajtur Modeli Shqiptar i Tregut të Energjisë Elektrike, parashikon zhvillimin mbi baza me te konsoliduara te tregut te energjisë elektrike dhe përputhshmëri më të plotë me Direktivat e Bashkimit European dhe parashikohet te kete nje qëndrueshmëri me te gjate se faza tranzitore qe parashikonte modeli i meparshem.

Modeli i Tregut i paraqitur merr ne konsiderate:

- Hapat qe ka ndermarre Qeveria nga struktura vertikalisht e integruar e sektorit elektroenergjetik, drejt ndarjes se veprimtarive ne shoqeri gjenerimi, transmetimi dhe shperndarje, ligjerisht, funksionalisht dhe financiarisht te ndara.

- Objektivin politik te Qeverise per fillimin e procesit te privatizimit ne sektorin elektroenergjetik shqiptar.

- Pershtatjen e legjislacionit te energjisë elektrike me ate te Bashkimit European.

- Zhvillimin e tregut te energjisë elektrike mbështetur ne rregulla tregu dhe ne kode te

rrjetit të qarta, si kërkesa minimale teknike për një operim eficient të sistemit elektroenergjetik.

- Përfitime sa më të mëdha për klientët në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe shërbim cilësor e të qëndrueshëm.

- Vendosjen e aksesit për palët e treta, për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike, si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e një tregu transparent dhe jo-diskriminues të energjisë elektrike.

- Liberalizimin e tregut të energjisë elektrike duke krijuar një strukturë tregu që rrit interesin dhe numrin e pjesëmarrësve në të.

- Monitorimin e tregut të energjisë elektrike nga ERE, si një institucion i pavarur me autoritetin për të miratuar gjithë legjislacionin e nevojshëm sekondar për këto qëllime.

- Rregullat për kryerjen e transaksioneve në treg që janë transparente dhe jo-diskriminuese dhe që shmangin devijimet e mundshme të fondeve.

- Zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatoreve dhe njëkohësisht për rritjen e efikasitetit të sistemit elektroenergjetik shqiptar.

- Integrimin e tregut të energjisë elektrike të vendit tonë në Tregun Rajonal e më vonë në Tregun Europian të Energjisë Elektrike.

Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike mund të jetë objekt përditësimi në funksion të zhvillimeve që do të ketë sektori elektroenergjetik shqiptar dhe angazhimeve që vendi ynë mund të marrë në kuadrin e bashkëpunimit rajonal.

1. Qëllimi dhe objekti

1.1 Synimi i Modelit të Tregut

- Të krijoje kushte për të shkuar drejt një tregu të konsoliduar.
- Të sigurojë fluks fondesh dhe llogarish transparente dhe eficientë.
- Të lejojë tregtim të energjisë elektrike, import dhe eksport, të orjentuara nga tregu, duke ruajtur përfitimet për Klientët.

1.2 Kërkesat që Modeli i Tregut të funksionojë në mënyrë efektive

- Të egzistojnë llogari transparente për tregun e rregulluar, si dhe për operatorët e rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes.

- Të ketë mbikqyrje rregullatore nga ERE.

- Të ketë strukturë të monitorimit të tregut dhe të raportimit të të dhënave.

- Rregullat e tregut dhe kodet perkatese të jenë fleksibel dhe njëkohësisht të mbrojnë në mënyrë efektive nga çdo mundësi abuzimi dhe praktikash të pandershme tregtare.

1.3 Synime të tjera me rëndësi të Modelit të Tregut

- Të marrë në konsideratë shndërrimin e KESH-it nga një shoqëri vertikalisht e integruar në një strukturë me entitete të ndara ligjrisht, financiarisht dhe funksionalisht.

- Të krijoje strukturën e nevojshme që konkurrenca të zhvillohet si në tregun e shitjes me shumicë ashtu edhe për Klientët e Kualifikuar.

- Të krijoje strukturën e nevojshme ligjore dhe rregullatore për privatizimin e industrisë elektroenergjetike, duke filluar me sektorin e Shpërndarjes.

- Të zbatojë politiken e qeverisë për krijimin e një Operatori Sistemi Transmetimi (OST) të pavarur dhe për të rritur transparencën në operimin dhe funksionimin e tregut.

- Të përcaktojë përgjegjësitë e Furnizuesit Publik me shumicë për menaxhimin e risqeve hidrologjike të hidrocentraleve me objektiv për të minimizuar kostot e furnizimit të Furnizuesit Publik me Pakicë në përfitim të Klienteve Tarifore.

2. Përcaktimet

Termat dhe shkurtime të përdorura në këtë dokument kanë kuptimin e mëposhtëm:

- **“Tregu i energjisë elektrike”** është shkembimi i kërkesës dhe ofertes për blerjen, shitjen dhe furnizimin e energjisë elektrike.

- **“ERE”** do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, baza ligjore për ushtrimin e përgjegjësive të cilit përcaktohet nga ligji nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- **“Rregulla Tregu”** do të thotë teresia e rregullave të miratuara nga ERE që përcaktojnë procedurat për operimin dhe menaxhimin e tregut, si dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

- **“Sistemi elektroenergjetik”** është një sistem i ndërlidhur i përbërë nga centralët e prodhimit të energjisë elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike tek konsumatorët.

- **“Shërbime ndihmese”** janë të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes;

- **“KESH”** do të thotë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.

- **“OST”** do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit.

- **“KESH Gen”** do të thotë një strukturë brenda KESH-it me license për prodhimin e energjisë elektrike.

- **“Furnizues Publik me Shumicë”** është një strukturë brenda KESH-it e ndarë funksionalisht dhe financiarisht, me license për blerjen e energjisë elektrike nga KESH Gen-i, PPE-te, PVE-te, apo tregtuesit, me qëllim shitjen tek Furnizuesi Publik me Pakicë.

- **“Shoqëria e Shpërndarjes”** do të thotë shoqëria me license për kryerjen e funksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të furnizimit publik me pakicë.

- **“OSSH”** do të thotë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, që kryen funksionin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- **“Furnizuesi Publik me Pakicë”** është një strukturë e organizuar brenda Shoqërisë së Shpërndarjes, e ndarë funksionalisht dhe financiarisht, me license për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike të Klienteve Tarifore.

- **“PVE”** do të thotë prodhues i vogël i energjisë elektrike i lidhur në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike.

- **“PPE”** do të thotë prodhues i pavarur i energjisë elektrike i lidhur në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

- **“Furnizues i Kualifikuar”** është një pjesëmarrës i tregut, i licensuar për të furnizuar me energji elektrike Klientët e Kualifikuar.

- **“Tregtues”** është person i licensuar që blen dhe shet energji elektrike, me përjashtim të shitjes tek furnizuesi publik me pakicë dhe të klientet fundorë.

- **“Blerje e energjisë ekonomike”** janë blerjet e energjisë elektrike nga KESH Gen-i, për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale.

- **“Klient Tarifor”** është një konsumator i energjisë elektrike që blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Pakicë.

- **“Klient i Kualifikuar”** është konsumatori i energjisë elektrike që ka të drejtë të zgjedhë furnizuesin e tij, nga i cili blen energjinë elektrike për nevojat e veta.

- **“AKBN”** do të thotë Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

- **“Kontrata dypaleshe”** janë marrëveshje që lidhin pjesëmarrës të ndryshëm të tregut në shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike, si dhe shërbimeve ndihmese.

- **“Fluksi i fondeve”** është shkembimi i vlerave monetare kundrejt shlyerjes së detyrimeve kontraktore ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

- **“Fluksi i energjisë elektrike”** është sasia e energjisë elektrike që kalon në rrjetat e transmetimit dhe të shpërndarjes.

3. Modeli i Tregut

3.1 Synimet dhe Objektivat:

Modeli Shqiptar i Tregut është dizenuar që të çojë përpara politikat e Qeverisë Shqiptare në fushat e mëposhtme:

i) Në krijimin e një kuadri për reformimin e sektorit elektroenergjetik, përfshirë privatizimin e funksioneve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice në një periudhë afat-shkurter. Ky kuader do të sigurojë një bazë të shëndoshe për privatizimin e segmenteve të tjera të sektorit elektroenergjetik.

ii) Në levizjen drejt përputhjes me Direktivat e BE-së dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

iii) Në vendosjen e kontratave dypaleshe me një treg të thjeshtë të rregulluar balancimi për transaksionet e energjisë, të cilat do të përmirësojnë transparencën dhe do të shmangin “mbivendosjen” e transaksioneve pa qenë të nevojshme.

iv) Në ruajtjen e vlerës së plotë të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve hidro në favor të klienteve tarifore shqiptare.

v) Në përmirësimin e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit elektroenergjetik duke qartësuar përgjegjësitë dhe detyrimet, si dhe duke siguruar flukse të mjaftueshme të informacionit lidhur me operimin e tregut dhe duke krijuar një strukturë të qartë për transaksionet e tregut elektroenergjetik.

vi) Në sigurimin e përfitimeve për klientët.

Këto synime dhe objektiva janë në përputhje dhe reflektojnë gjithashtu zhvillimin e mëtejshëm të synimeve dhe objektivave të parashtruara në Seksionin A të Modelit Tranzitor të Tregut, që është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.539 datë 12 gusht 2004. Mbas miratimit nga Qeveria, Modeli Shqiptar i Tregut do të zëvendësojë Modelin Tranzitor të Tregut.

4. Pjesëmarrësit dhe karakteristikat e Modelit të Tregut

Modeli i Tregut trajton gjithashtu përgjegjësitë dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE).

Modeli Shqiptar i Tregut, në kuptimin e gjërë, karakterizohet nga kontrata dypaleshe të energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

Shërbimet ndihmëse për Sistemin e Transmetimit blihen nga OST-ja.

Rregullimi i çmimeve, termave dhe kushteve të tjera në kuadrin e Modelit të Tregut është gjithëpërfshirës. Ai reflekton situatën monopol në të ardhmen e afërt të KESH-Gen-it, OSSH-së, Furnizuesit Publik me Shumicë, Furnizuesit Publik me Pakicë dhe OST-së.

Të gjitha kontratat dhe tarifat ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut, do të jenë të rregulluara, që në përkrahjen e tyre, me përjashtim të:

a) Kontratave respektive ndërmjet, Tregëtuesve dhe Furnizuesve të Kualifikuar nga njëra anë dhe Furnizuesit Publik me Shumicë dhe Klienteve të Kualifikuar nga ana tjetër.

b) Kontratave ndërmjet PVE-ve, PPE-ve dhe Klienteve të Kualifikuar.

c) Kontratave ndërmjet KESH-Gen-it nga njëra anë dhe Furnizuesve të Kualifikuar dhe Tregëtuesve, nga ana tjetër, në masën që lejohet nga kufizimet e tjera ndaj shitjeve të KESH-Gen-it.

d) Kontratave ndërmjet PVE-ve, PPE-ve nga njëra anë dhe tregëtarëve nga ana tjetër.

4.1 OST-ja

Është shoqëri e pavarur shtetërore që kryen këto funksione:

- Operimin e rrjetit të transmetimit nga pikëpamja fizike (posedim, mirëmbajtje dhe zgjerim) (ORrT);

- Operatorin e Sistemit nga pikëpamja e dispecerimit (OS);

- Operatorin e Tregut (duke siguruar që informacioni për likuidimin e kontratave është i disponueshëm, që me pas mund të shërbejë si një burse e energjisë elektrike).

OST-ja verifikon:

Informacionin ne se Furnizuesi Publik me Shumice dhe OSSH-ja i kane siguruar te gjitha burimet e mjaftueshme per te furnizuar Klientët tarifore dhe per te mbuluar humbjet ne shperndarje, sipas grafikeve te ngarkeses vit, muaj, jave dhe dite ne avance.

OST-ja ka autoritet:

T'i kerkoje Furnizuesit Publik me Shumice dhe OSSH-se qe te bejne blerje energjie ne përputhje me nevojat per energji te Furnizuesit Publik me Pakice per Klientet Tarifore dhe per humbjet ne sistemin e shperndarjes.

T'i kerkoje Klienteve te Kualifikuar te vertetojne se ata do te jene ne gjendje te sigurojne furnizimin e mjaftueshem per veten e tyre.

T'i kerkoje Furnizuesve te Kualifikuar te vertetojne se jane ne gjendje te sigurojne furnizimin e mjaftueshem me energji elektrike te Klienteve te Kualifikuar.

T'i kerkoje KESH Gen-it, PPE-ve, PVE-ve dhe ngarkesave te dispecerueshme informacion qe demonstron se ata kane kapacitetin ose ngarkesen qe te permbushin angazhimet e tyre.

OST-ja:

Parashikon dhe blen nga KESH Gen dhe pjesmarresit e tjere te tregut, shërbime ndihmese sipas nevojës vit, muaj, dite ne avance dhe ne kohe reale.

Blen energji elektrike nga KESH Gen-i dhe pjesmarresit e tjere te tregut, per te mbuluar humbjet ne sistemin e transmetimit.

Kompensohet per shërbimet nga pjesmarrësit qe i perfitojne ato, sipas tarifave te miratuara nga ERE-ja.

4.2 Gjenerimi (KESH Gen)

I shet OST-se sherbime ndihmese dhe energji elektrike per te mbuluar humbjet teknike ne transmetim.

I shet Furnizuesit Publik me Shumice energji elektrike sipas kerkesave te tij me çmim te miratuar nga ERE-ja. Shitja behet sipas marrëveshjeve vjetore ose per periodha te tjera te miratuara nga ERE-ja.

I shet Furnizuesit Publik me Shumice energji elektrike shtese per te plotesuar kerkesat e klienteve tarifore me cmim te miratuar nga ERE-ja.

Shet energji ne tregun vendas ose ate te eksportit ne përputhje me rregullat dhe procedurat e shitjes se energjisë elektrike te miratuara nga ERE-ja.

Shkemben energji elektrike ne tregun e ekportit ne përputhje me rregullat e procedurat e shkembimit te miratuara nga ERE-ja ose sic mund te jete rene dakort nga autoritetet kompetente ne kuadrin e Traktatit te Komunitetit te Energjise ose marreveshje te tjera rajonale.

Ben blerje ekonomike te energjise elektrike, për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale.

Te gjitha perfitimet neto nga kapaciteti hidro vendas ruhen per klientët tarifore.

ERE-ja monitoron qe ky proces i shitjes dhe shkembimit te energjisë elektrike te jete ne përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga ERE-ja per shitjen dhe shkembimet e energjisë elektrike.

4.3 Prodhuarit e Vegjel te Energjise Elektrike (PVE)

Prodhuarit te vegjel jane centralet e vegjel gjenerues te energjise elektrike, qe lidhen ne sistemin e shperndarjes.

PVE-te me license gjenerimi mund te shesin energji elektrike te Furnizuesit e Kualifikuar ose Tregtuesit ose OSSH, me terma te negociura lirisht.

PVE-te mund te shesin energji elektrike te Furnizuesi Publik me Shumice me cmime te rregulluara.

ERE-ja percakton tarifa te thjeshta e te njehsuara te shitjes se energjisë elektrike nga prodhuarit e vegjel ne tregun e rregulluar.

PVE-te mund te shesin energji elektrike tek OST-ja -ja per te mbuluar humbjet e energjise sipas kontratave te miratuara nga ERE-ja.

Nje PVE mund te aplikojë per licensen e Furnizuesit te Kualifikuar nese zgjedh t'i shese direkt energji Klienteve te Kualifikuar.

4.4 Prodhuesit e Pavaruar te Energjisë Elektrike (PPE)

PPE-te jane prodhuesit e pavaruar qe lidhen direkt ne sistemin e transmetimit.

PPE-te licensohen nga ERE-ja dhe mund te shesin kapacitete ose energji OST-se dhe OSSH-se, per te mbuluar humbjet ne sistemin e transmetimit dhe shperndarjes, Klienteve te Kualifikuar, Furnizuesve te Kualifikuar ose Tregtareve me cmime tregu ose Furnizuesit Publik me Shumice me çmim te regulluar dhe kontrate te miratuar nga ERE-ja.

Nje PPE mund te aplikojë per license te Furnizuesit te Kualifikuar nese ai zgjedh t'i shese direkt Klienteve te Kualifikuar.

4.5 Furnizuesit e Kualifikuar (FK)

Furnizues te Kualifikuar jane:

Furnizuesit vendas ose te huaj te licensuar nga ERE-ja, te cilet mund te blejne energji nga tregtuesit, nga PVE-te ose nga PPE-te per t'jua shitur Klienteve te Kualifikuar. Furnizuesit e Kualifikuar mund t'u shesin energji edhe Furnizuesit Publik me Shumice, Tregtuesve ose Furnizuesve te Kualifikuar te tjere.

PVE-te dhe PPE-te duhet te licensohen qe te behen Furnizues te Kualifikuar, nese ata vendosin qe t'i shesin direkt energji elektrike Klienteve te Kualifikuar.

Furnizuesit e Kualifikuar kane detyrimin t'i demostrojne OST-se qe ato kane kapacitet dhe energji te mjaftueshme per te permbushur kerkesat e Klienteve te tyre te Kualifikuar.

4.6 Tregtuesit

Tregtuesi eshte person i licensuar qe blen dhe shet energji elektrike, me perjashtim te shitjes tek furnizuesi publik me pakice dhe te klientet fundore.

Jane subjekte private vendase ose te huaja, qe blejne dhe shesin energji elektrike me shumice.

Tregtuesit licensohen nga ERE-ja.

Tregtuesit mund te blejne energji nga KESH Gen (per surplusen), PVE-te dhe PPE-te, per t'ja shitur Furnizuesve te Kualifikuar, Furnizuesit Publik me Shumice ose OSSH-se (per humbjet).

PPE-te ose PVE-te kur i shesin energji elektrike vetem Furnizuesit Publik me Shumice ose Furnizuesit e Kualifikuar paisen vetem me license prodhimi dhe jo me license tregtimi.

PPE-te, PVE-te ose Furnizuesit e Kualifikuar duhet te kene license tregtimi qe te jene tregtues.

ERE-ja do te siguroje qe licensat dhe procedurat e licensimit per Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit jane te thjeshta, jo-diskriminuese dhe nuk krijojne pengesa te panevojshme per hyrjen e Tregtuesve ne tregun shqiptar, si dhe jane subjekt i marreveshjeve te reciprocitetit. Kerkesat e licensimit do te detyrojne Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit t'i sigurojne ERE-s informacion lidhur me veprimtarite e tyre dhe aftesite e tyre teknike dhe financiare, si dhe se Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit zbatojne te gjitha rregullat e aplikueshme te tregut dhe kodet e rrjetit.

4.7 Furnizuesi Publik me Shumice

Furnizuesi Publik me Shumice ka pergjegjesi per blerjen e energjisë elektrike, per te siguruar furnizim te mjaftueshem per Furnizuesin Publik me Pakice sipas kerkeses se ketij te fundit per furnizimin pa nderprerje te Klienteve Tarifore.

Furnizuesi Publik me Shumice ka pergjegjesine qe te sherbeje si sigurues i alternatives se fundit per te gjithë klientët.

Furnizuesi Publik me Shumice ka pergjegjesine t'i vertetoje OST-se se ka siguruar furnizim te mjaftueshem me energji per te plotesuar kerkesen e Furnizuesit Publik me Pakice.

Furnizuesi Publik me Shumice ka te drejten te bleje nga KESH Gen-i te gjithë energjine elektrike te prodhuar prej tij nga burimet hidro dhe burimet e tjera gjeneruese, dhe nga PPE-te,

PVE-te, Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit per te permbushur detyrimet e tij ndaj Furnizuesit Publik me Pakice, qe t'u sherbeje te gjitha Klienteve Tarifore.

Marreveshja ndermjet KESH Gen-it dhe Furnizuesit Publik me Shumice duhet te reflektroje optimizimin e duhur te prodhimit te KESH Gen-it me synim minimizimin e kostos totale te furnizimit qe i ngarkohet Furnizuesit Publik me Pakice dhe qe i kalohet Klienteve Tarifore.

Furnizuesi Publik me Shumice ka te drejte te mbuloje, nepermjet kontrates se tij me Furnizuesin Publik me Pakice, te gjitha kostot e realizuara per blerjen e energjise, perfshire koston e energjise elektrike te importuar si dhe kostot e blerjeve nga KESH Gen-i, PPE-te, PVE-te, Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit.

Furnizuesit Publik me Shumice i kerkohet te siguroje te gjitha furnizimet e disponueshme, perfshire importet, per te shmanguar kufizimin e ngarkeses. Furnizuesi Publik me Shumice, me miratimin e ERE-s, mund te refuzoje blerjen e energjise elektrike kur kostoja e furnizimit kalon vleren e koston se mosfurnizimit te percaktuar nga ERE-ja ne perputhje me politiken e qeverise dhe ne konsultim me Keshillin e Ministrave.

4.8 Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH)

OSSH-ja zoteron, miremban, zgjeron dhe operon sistemin e shperndarjes ne te gjitha Shqiperine.

OSSH-ja eshte pergjegjese per blerjen e energjise elektrike per te mbuluar te gjitha humbjet ne sistemin e shperndarjes. OSSH-ja mund ta bleje kete energji nga cdo pjesmarres tregu me cmime tregu.

OSSH-ja i siguron shërbim lidhjeje dhe shperndarjeje Klienteve Tarifore, PVE-ve dhe Klienteve te Kualifikuar te lidhur ne shperndarje, mbi baza jo diskriminuese.

Tarifat, termat dhe kushtet e shërbimeve te shperndarjes qe sigurohen nga OSSH-ja rregullohen nga ERE-ja.

OSSH-ja eshte pergjegjese per reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike ne sistemin e shperndarjes, sipas kushteve te percaktuara nga ERE-ja. ERE-ja mund te percaktojte per OSSH-ne nje tarife qe siguron incentiva per reduktimin e ketyre humbjeve.

4.9 Furnizuesi Publik me Pakice

Furnizuesi Publik me Pakice i shet energji elektrike, sipas nje kontrate me kushte dhe tarifa te rregulluara nga ERE-ja, vetem klienteve tarifore.

Furnizuesi Publik me Pakice blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumice me tarifa te miratuara nga ERE-ja.

Furnizuesi Publik me Pakice ka pergjegjesine t'i siguroje OST-se dhe Furnizuesit Publik me Shumice, grafiket e ngarkeses vjetore, mujore, javore dhe ditore ne avance ne menyre qe t'i mundesoje Furnizuesit Publik me Shumice dhe OST-se te pergatisin programet e tyre.

Furnizuesi Publik me Pakice eshte pergjegjes per reduktimin e mosarketimeve nga klientet tarifore sipas kushteve te percaktuara nga ERE-ja. ERE-ja mund te percaktojte per Furnizuesin Publik me Pakice nje tarife qe siguron incentiva per reduktimin e ketyre mos-arketimeve.

4.10 Klientët tarifore

Kliente tarifore jane ata kliente qe blejne energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Pakice me tarifa te rregulluara nga ERE-ja.

4.11 Klientët e Kualifikuar

Klientet e Kualifikuar jane kliente qe mund te blejne energji elektrike nga Furnizuesit e Kualifikuar sipas ligjit dhe procedurave te miratuara nga ERE-ja.

Çdo klient është i lirë te zgjedhe te mbetet klient tarifar apo te behet i kualifikuar nese ploteson kushtet perkatese.

ERE-ja harton regulla per te percaktuar kushtet ne te cilat nje klient mund te kthehet ne kategorine e klienteve tarifore pasi ka zgjedhur te behet klient i kualifikuar.

Klientet e Kualifikuar do t' sigurojne OST-se informacionin lidhur me ngarkesen e tyre te pritshme.

4.12 Rregullatori i Pavarur (ERE)

ERE-ja është përgjegjëse:

a) per percaktimin e te drejtave dhe detyrimeve respektive te pjesëmarrësve te tregut, sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jo diskriminuese qe sigurojne aksesin e paleve te treta;

b) per te siguruar kontroll rregullator per tregun e energjisë elektrike;

c) ne përputhje me ligjin per sektorin e energjisë elektrike, ERE-ja do t'i kerkoje te licensuarve te veprojne ne nje mënyrë te tille qe te sigurojne sigurine e furnizimit afat-shkurter dhe afat-gjate dhe te mos perfshihen ne praktika te pandershme ose te ushtrojne pushtet tregu. ERE-ja kerkon nga Furnizuesi Publik me Shumice ekzekutimin e marreveshjeve te blerjes se energjise elektrike per aq kohe sa ato kerkesa jane ne perputhje me strategjine kombetare te hartuar nga Keshilli i Ministrave dhe cdo marreveshje privatizimi.

Baza ligjore per ushtimin e këtyre pergjegjesive nga ERE-ja sigurohet nga ligji nr. 9072, date 22.05.2003 "Per Sektorine Energjisë Elektrike", i ndryshuar.

4.13 Marrëdhëniet mes pjesmarrësve te tregut

Marrëdhëniet dhe roli i pjesmarrësve te tregut ne operimin fizik te Modelit te Tregut bazohet ne kontrata dypaleshe mes pjesmarrësve te ndryshem ne përputhje me percaktimet e meposhtëme:

A) Tregu i rregulluar

1. Ndermjet KESH Gen-it dhe Furnizuesit Publik me Shumice (te pakten me qellim per berjen transparent te cmimeve qe do te vendose KESH Gen-i ndaj Furnizuesit Publik me Shumice);

2. Ndermjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice;

3. Ndermjet OST-se dhe pjestareve te tjere te tregut per transmetimin perfshire shërbimet ndihmese;

4. Ndermjet OSSH-se dhe pjestareve te tjere te tregut per shperndarjen dhe shërbimet qe lidhen me te;

5. Ndermjet PVE-ve e PPE-ve dhe Furnizuesit Publik me Shumice;

6. Ndermjet Furnizuesit Publik me Pakice dhe klienteve te tij tarifore;

7. Ndermjet KESH Gen-it dhe Tregtuesve, perfshire kontratat e importeve, per shkembimet e energjise, te cilat jane objekt i monitorimit dhe rregullave te prokurimit te ERE-s;

8. Ndermjet OST-se dhe KESH Gen-it, PVE-ve, PPE-ve dhe Tregtuesve, per humbjet e transmetimit dhe Shërbimet Ndhmese.

ERE-ja mund te miratoje marrëveshje tip, te cilat jane te detyrueshme per zbatim nga Furnizuesit e Kualifikuar, PPE-te, PVE-te dhe pjesëmarrësit e tjere te tregut kur lidhin marreveshje dypaleshe me Furnizuesin Publik me Shumice.

B) Tregu i parregulluar

8. Ndermjet Furnizuesve te Kualifikuar dhe Klienteve te Kualifikuar;

9) Ndermjet PVE-ve, PPE-ve, Furnizuesve te Kualifikuar dhe Tregtuesve;

10) Ndermjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe PPE-ve, PVE-ve, Furnizuesve te Kualifikuar dhe Tregtuesve;

11) Ndermjet OSSH-se dhe Tregtuesve, Furnizuesve te Kualifikuar, PPE-ve dhe PVE-ve per energjine e nevojshme per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes.

Te gjitha marreveshjet ne tregun e parregulluar jane objekt monitorimi nga ERE per te siguruar funksionimin sic duhet te tregut dhe se pjesmarresit e tregut nuk ushtrojne pushtet tregu ose ndjekin praktika te pandershme. Marredheniet e ndryshme kontraktuale ndermjet OST-se, KESH Gen-it, Furnizuesit Publik me Shumice, OSSH-se, Furnizuesit Publik me

Pakice, Klienteve Tarifore, Klienteve te Kualifikuar, PVE-ve, PPE-ve, Tregetuesve dhe Furnizuesve te Kualifikuar paraqiten ne Shtojcat B dhe C.

Shtojca A paraqet flukset e energjisë elektrike ndermjet subjekteve te ndryshme.

5.Karakteristikat Kryesore te Modelit te Tregut

5.1 Parashikimi Afatgjate dhe Parashikimi Operacional

OST-ja ka per detyre te pergatitise parashikime 15-vjecare per nevojat e vendit per energji elektrike dhe parashikime operacionale.

- Kete parashikim OST-ja i mbështet mbi parashikimet e pjestareve te tregut;
- Furnizuesi Publik me Shumice;
- OSSH-ja dhe Furnizuesi Publik me Pakice;
- KESH Gen-i, PPE-te dhe PVE-te;
- Furnizuesit e Kualifikuar, Klientet e Kualifikuar dhe pjesmarresit e tjere te tregut;
- Tregtuesit (perfshire importet/eksportet);
- Si dhe parashikimet e bera nga AKBN-ja ose agjensi te tjera shteterore te specializuara.

OST-ja është e detyruar te ruaje konfidencialitetin e informacionit te siguruar nga pjestaret e tregut ne ato raste kur nxjerrija e tij demton konkurrencen.

Per permbushjen e detyrimit te saj te parashikimit OST-ja krijon nje departament te vecante parashikimi me ekspertizen e nevojshme.

5.2 Kontrata e Furnizimit te nje Viti ne Avance

i) Shërbime Ndhimese:

OST-ja eshte pergjegjese per blerjen, nepermjet kontrates, te shërbimeve ndihmese, qe i nevojiten sistemit ne përputhje me parashikimet e mesiperme.

KESH Gen-i i ofron OST-se per te shitur shërbime ndihmese sipas marrëveshjes vjetore te shërbimeve ndihmese qe negociohet midis tyre dhe miratohet nga ERE-ja.

Shërbimet ndihmese perfshijne edhe energjine balancuese.

OST-ja blen shërbime ndihmese shtese, ne rast se këto shërbime nuk ja sigurojne kontratat e lidhura, nga KESH Gen-i dhe nga PPE-te, Tregetuesit ose Furnizuesit e Kualifikuar per aq sa është e mundeshme.

ii) Energji Elektrike:

KESH Gen-i, pasi merr ne konsiderate kontraten per shërbimet ndihmese dhe energjine per te mbuluar humbjet teknike ne transmetim, i ofron Furnizuesit Publik me Shumice energji elektrike ne ate sasi dhe kapacitet qe kerkon, me cmime dhe kushtet te miratuara nga ERE-ja.

Kur energjia, qe Furnizuesi Publik me Shumice ka blere sipas kontratave nga KESH Gen-i, nuk është e mjaftueshme per te plotesuar nevojat me energji elektrike te Furnizuesit Publik me Pakice, Furnizuesi Publik me Shumice mund te bleje energji shtese nga KESH Gen-i, PVE-te, PPE-te ose/dhe Tregtuesit.

5.3 Muaji ne avance

Jo me vone se 10 dite para nje muaji te caktuar ne Vitin ne Avance, OST-ja do te hartoje dhe publikoje nje Plan Mujor Operimi per operimin e sistemit elektroenergjetik te bazuar ne informacionet mujore te siguruar nga pjesmarrësit e tregut.

Plani Mujor i Operimit per muajin ne advance do te permbaje:

- kerkesen per energji elektrike dhe mbulimin nga prodhimi vendas;
- energjine e importuar te programuar;
- grafiket tip te ngarkeses javore dhe ditore gjate muajit per ditet e punes, per ditet e shtuna e te djela dhe per ditet e festave, si dhe grafiku tip mujor i ngarkeses;
- verifikimin e nivelit te liqenit te Fierzes;
- planin mujor te shërbimeve te mirembajtjes dhe shërbimeve te tjera te programuara te gjeneratoreve;
- planin mujor per shërbime ndihmese;
- vleresimin e operimeve te parashikuara ne terma te qëndrueshmërise dhe sigurisë se

sistemit elektroenergjitik dhe masat e parashikuara gjate muajit per te ruajtur sigurine dhe qëndrueshmërine sipas nevojës.

Per te ndihmuar OST-ne ne përgatitjen e Planit Mujor te Operimit, pjesëmarrësit e tregut (KESH Gen-i, OSSH-ja, Furnizuesi Publik me Shumice, Klientët e Kualifikuar, Furnizuesit e Kualifikuar, Tregtuesit, PPE-te, etj), do t'i japin OST-se informacionin e kerkuar te specifikuar, jo me vone se 20 dite para fillimit te muajit per te cilin është pergatitur plani.

5.4 Java ne avance

Perpara cdo jave operimi, dhe mbeshetur ne informacionin te siguruar nga Furnizuesi Publik me Shumice (ne bashkerednim me Furnizuesin Publik me Pakice), PPE-te, PVE-te dhe Klientet e Kualifikuar (ose Furnizuesit e Kualifikuar) duhet te pergatise parashikimin ditor te ngarkeses per javen e ardhshme duke e perditesuar ate me OST-ne. Perpara cdo jave operimi, Furnizuesi Publik me Shumice bazuar ne kontratat dypaleshe percakton sasine e nevojshme te energjisë elektrike qe ajo do te kerkoje nga KESH Gen-i per te mbuluar ngarkesen javore.

OST-ja do te mbuloje mungesat e furnizimit te energjisë elektrike nga KESH Gen-i, PVE-te, PPE-te, Tregtuesit ose Furnizuesit e Kualifikuar nepermjet Sherbimeve Ndihtese, ose do te zbatoje kufizime te ngarkeses sipas seksionit 4.12 c.

5.5 Dita ne Avance dhe Axxustimet Ditore

Furnizuesi Publik me Pakice mund te rishikoje projeksionet e tij te parashikimit te ngarkeses kur nga përditësimi i ngarkeses se parashikuar jane te qarta diferencat ndermjet energjisë se parashikuar dhe te asaj te kerkuar. Furnizuesi Publik me Pakice duhet te njoftoje OST-ne dhe Furnizuesin Publik me Shumice per rishikimin. Kur modifikimet e parashikimit justifikojne vendimin, Furnizuesi Publik me Shumice mund te bleje energji elektrike, jashte kontratave te meparshme, nga KESH Gen-i me cmime te rregulluara, nga PVE-te qe kane kontrate me Furnizuesin Publik me Shumice me tarifa te përcaktuara nga ERE-ja, si dhe nga PVE-te e tjera, PPE-te dhe tregtuesit me cmime te parregulluara.

Ne rast se parashikimet e perditesuara te dites ne avance tregojne se kerkohet energji elektrike shtese nga ajo qe mund te sigurohet nga te gjitha burimet e disponueshme, perfshire PVE-te, PPE-te, Tregtuesit dhe Furnizuesit e Kualifikuar, OST-ja mund t'i imponoje OSSH-se ose Klienteve te Kualifikuar axhustime brenda dites duke vendosur procedura te kufizimit te ngarkeses per te mbajtur sistemin elektroenergjetik te balancuar. Ne rast se parashikimet e perditesuara te dites ne avance tregojne se kerkohet me pak energji se sa ajo qe është parashikuar, OST-ja mund te imponoje axhustime per te balancuar parashikimin e ngarkeses se dites ne avance duke ulur furnizimet e blera nga PVE-te, PPE-te ose Tregtuesit.

5.6 Procedurat tipike qe ndiqen nga OST-ja

OST-ja ka pergjegjesine te dispeceroje te gjitha njesite ne zoterim te KESH Gen-it dhe te PPE-ve, te nevojshme per te mbuluar ngarkesen, si dhe ngarkesat e dispecerueshme te Klienteve te Kualifikuar, duke respektuar te gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara ne Kodin e Rrjetit per:

- a) ditën e operimit
- b) ditën pas dites se operimit
- c) ditën e peste pas dites se operimit
- d) axhustimet e nje dite ne avance dhe brenda dites

OST-ja do te vendose, me miratimin e ERE-s, procedura operimi qe percaktojne afate kohore ("gate closure") per nominimin (percaktimin) fizik dhe rregulla te tjera qe i kerkohen OST-se per te kryer funksionet e saj te dispecerimit dhe balancimit.

OST-ja do te krahasoje shumën e parashikimeve te ngarkeses te marrë nga pjestaret e tregut me parashikimet e saj dhe te vendose se cfare hapash te metejshem (p.sh blerje) mund te jene te nevojshme per te balancuar sistemin.

ERE-ja ka pergjegjesine, qe Rregullat e Tregut te pershkruajne ne mënyrë te detajuar te gjitha veprimet operative qe duhet te kryeje OST-ja per dispecerimin dhe te veprimtarive te

tjera te perfshira ne sistemin elektroenergjetik.

5.7 Shitjet e KESH Gen-it tek bleres te tjere

Marrëveshjet e furnizimit ndërmjet KESH Gen-it dhe Furnizuesit Publik me Shumice do të sigurojnë që përfitimet nga kapacitetet hidro të KESH Gen-it të jenë për Klientët Tarifore. Megjithatë, KESH Gen-i, në përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga ERE-ja mund të shesë cdo kapacitet të tij të tepert mbi sasinë e kontraktuar me Furnizuesin Publik me Shumice me çmime të parregulluara.

KESH Gen-i mund të shesë energjinë elektrike të prodhuar prej tij në tregun me çmime të parregulluara duke siguruar blerje ekonomike në përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga ERE-ja për shitjen e energjisë elektrike dhe me rregullat për eksportin e energjisë elektrike.

KESH Gen-i mund të kryejë procedurat e shitjes së energjisë elektrike me kusht që:

1. Të ketë marrë licencën përkatëse të energjisë elektrike nga ERE-ja për të shitur energji elektrike.

2. Termat e kësaj shitje, të përcaktuara nga ERE-ja në rregullat dhe procedurat e shitjes nuk do të reduktojnë përfitimet e përgjithshme të klienteve tarifore dhe nuk do të pengojnë përmbushjen e detyrimeve të KESH Gen-it sipas kontratave të tij me OST-ne dhe Furnizuesin Publik me Shumice.

KESH Gen-i do të mbajë riskun tregëtar dhe të kreditimit si pasoje e këtyre shitjeve dhe të plotësimit të detyrimit të vazhdueshëm për furnizimin me energji elektrike të OST-se dhe Furnizuesit Publik me Shumice.

Çdo fitim neto nga shitjet ose shkembimet e energjisë elektrike të bera nga KESH Gen-i, nëse do të ketë, do të reflektohet në përfitim të klienteve tarifore. Megjithatë, ERE-ja mund të marrë në konsideratë dhe të adoptojë mekanizma nxitëse që do të vlerësohen të përshtatshëm nga ana e saj, përfaqësojë edhe lejimin e KESH Gen-it për të mbajtur një pjesë të fitimit neto nga eksporti.

6. Fluksi i Fondeve

Fluksi i fondeve në Modelin e Tregut tregohet në Shtojcën D.

Fluksi i fondeve për pjesëmarrësit Kryesorë të tregut është përmbledhur si më poshtë:

6.1 OST-ja

Të pagueshme:

OST-ja do t'i paguajë KESH Gen-it, PPE-ve, Tregtuesve dhe Furnizuesve të Kualifikuar për shërbimet ndihmëse dhe për energjinë e nevojshme për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit të blera nga ajo.

Të arkëtueshme:

a) Klientët e Kualifikuar, KESH Gen-i, Furnizuesi Publik me Pakicë, PPE-të, PVE-te dhe OSSH-ja (për energjinë e blerë për të mbuluar humbjet) do t'i paguajnë OST-së pagesat e transmetimit (për aq sa aplikohet) të llogaritura në përputhje me tarifën që përfshihet në Marrëveshjen e Shërbimit të Transmetimit të miratuar nga ERE-ja,

b) si dhe pagesat për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit.

Te arkëtueshme/Te pagueshme:

Likuidimi i pjesëmarrësve të tregut për disbalancat (devijimet) sipas disbalancave (devijimeve) të tyre fizike (me përjashtim të një minimumi prej _%).

6.2 KESH Gen-i

Të pagueshme:

KESH Gen-i do t'i paguajë OST-së (për aq sa aplikohet) për shërbimin e transmetimit të siguruar sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja;

KESH Gen-i do t'i paguajë PVE-ve, PPE-ve, Tregtuesve dhe Furnizuesve të Kualifikuar për blerjet e energjisë ekonomike (që do të thotë energji që mund të jetë e disponueshme në kohe të caktuara të ditës ose vitit e që mund të blihet më lirë nga sa mund ta

prodhonte KESH Gen-i dhe që mund të përdoret ekonomikisht për nevojat e centralit ose për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale).

Të arkëtueshme:

Furnizuesi Publik me Shumice do t'i paguajë KESH Gen-it për energjinë elektrike me tarifa të rregulluara;

OST-ja do t'i paguajë KESH Gen-it për shërbimet ndihmese dhe energji e blere për të mbuluar humbjet, ose do t'i paguajë ose marrë shuma për pjesëmarrjen e tyre në tregun e rregulluar të balancimit;

OSSH, Blerësit e tregut të eksportit, Tregtuesit dhe Furnizuesit e Kualifikuar do t'i paguajnë KESH Gen-it për energjinë elektrike për atë që do të lejohet shitja e kësaj energjie.

Humbjet në sistemin e transmetimit për shitjet e KESH Gen-it, PPE-ve dhe PVE-ve i përkasin OST-se.

Te arketueshme/Te Pagueshme:

Likuidimi i disbalances (devijimeve) të KESH Gen-it sipas disbalancave (devijimeve) fizike (me përjashtim të një minimumi prej _%).

6.3 Furnizuesi Publik me Shumice

Të Pagueshme:

Furnizuesi Publik me Shumice do t'i paguajë KESH Gen-it vlerën për të gjithë energjinë elektrike, të cilën ajo ka blere.

Furnizuesi Publik me Shumice do t'i paguajë PVE-ve, PPE-ve, Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesve vlerën për energjinë elektrike që ato i kanë shitur atij.

Furnizuesi Publik me Shumice do t'i paguajë OST-së pagesat për shërbimet e ofruara nga OST-ja, përfshirë koston e shërbimeve ndihmëse, sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Të arkëtueshme:

Furnizuesi Publik me Pakice do t'i paguajë Furnizuesit Publik me Shumice vlerën e energjisë elektrike të livruar me tarifa të miratuara nga ERE-ja.

6.4 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Të Pagueshme:

OSSH-ja do t'i paguajë PPE-ve, PVE-ve, Furnizuesve të Kualifikuar, Tregtuesve dhe KESH Gen-it (me çmime tregu) për energji e blere për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes.

OSSH-ja do t'i paguajë OST-së pagesat për shërbimin e transmetimit, përfshirë koston e shërbimeve ndihmëse, sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja, lidhur me energji e blere nga OSSH-ja për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes.

Të arkëtueshme:

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes (si Klientet Tarifore dhe Klientet e Kualifikuar të lidhur në sistemin e shpërndarjes) do t'i paguajnë OSSH-së për shërbimet e rrjetit të shpërndarjes sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Te arketueshme/Te Pagueshme:

Likuidimi i disbalances (devijimeve) të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sipas disbalancave (devijimeve) fizike (me përjashtim të një minimumi prej _%).

6.5 Furnizuesi Publik me Pakice

Të Pagueshme:

Furnizuesi Publik me Pakice do t'i paguajë Furnizuesit Publik me Shumice për energji elektrike të furnizuar për Klientet Tarifore sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Furnizuesi Publik me Pakice do t'i paguajë OST-së pagesat për shërbimin e transmetimit, përfshirë koston e shërbimeve ndihmëse, sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Furnizuesi Publik me Pakice do t'i paguajë OSSH-se pagesat për shërbimin e shpërndarjes sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Të arkëtueshme:

Klientët Tariforë do t'i paguajnë Furnizuesit Publik me Pakice për energjinë elektrike që u është livruar sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja. Furnizuesi Publik me Pakice do të propozojë tarifa që kanë lidhje me furnizimin e energjisë elektrike që do të rezultojnë në pagimin nga cdo Klient Tarifor brenda të njëjtes kategori klientesh në të gjithë vendin të njëjten tarife uniforme.

Te arketueshme/Te Pagueshme

Likuidimi i disbalances (devijimeve) të Furnizuesit Publik me Pakice sipas disbalancave (devijimeve) fizike (me përjashtim të një minimumi prej _%).

Fluksi i fondeve që përfshin këta dhe pjesmarrës të tjerë të tregut janë dhënë në Shtojcën D.

7. Roli i Rregullatorit të Pavarur ERE

ERE-ja e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", me të gjitha ndryshimet. Funksionimi i rregullatorit të pavarur përmbush kërkesat e Direktivës së BE-së 2003/54 dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. ERE-ja i rekomandon Qeverisë Shqiptare modelin e tregut të energjisë elektrike dhe miraton të gjitha aktet nënligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pas miratimit të Modelit të Tregut nga Qeveria Shqiptare, ERE-ja do të procedojë me reflektimin e ndryshimeve në Rregullat e Tregut, dhe në aktet e tjera nënligjore që lidhen me funksionimin e tregut.

Në përgatitjen e këtyre dokumenteve ERE-ja do të marrë në konsideratë:

a) Marrëdhëniet mes Klientit të Kualifikuar ("KK") dhe Furnizuesit Publik me Pakice e OSSH-se. Këto marrëdhënie duhen trajtuar në mënyrë specifike në Rregullat e Tregut, që do të miratohen nga ERE-ja duke marrë parasysh që:

- Një Klient i Kualifikuar nuk mund të jetë njëkohësisht dhe Klient Tarifor.
- Klienti i Kualifikuar nuk mund të blejë energji elektrike nga KESH Gen-i (me përjashtim kur lejohet në mënyrë specifike nga ERE) ose Furnizuesi Publik me Shumice.
- Rregullat e Tregut duhet të përcaktojnë qartë rrethanat dhe pagesat për rikthimin e një Klienti të Kualifikuar si Klient Tarifor në mënyrë që të mbrojnë Klientët Tariforë nga rritja e kostove të shkaktuara nga ky rikthim.

b) ERE do të hartojë dhe miratojë rregulla për menaxhimin e bllokimeve kur linjat e transmetimit janë të kufizuara dhe nuk mund t'i përballojnë të gjitha kërkesat e Klientëve Tariforë dhe atyre të Kualifikuar. ERE do të sigurojë në Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut rregulla për zbatimin e kufizimit të ngarkesave ndërmjet Klientëve Tariforë dhe Klientëve të Kualifikuar kur ka mungesë të kapaciteteve, në mënyrë që të implementohet nga OST-ja. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimet e aksesit të hapur dhe jo-diskriminues me qëllim që të plotësojnë kërkesat e BE-se për akses të hapur dhe të përputhen me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Në hartimin e këtyre rregullave, duhet kërkuar kontributi i gjithë palëve të interesuara.

c) Tepricat e energjisë elektrike në disa periudha nga vetprodhuesit që prodhojnë energji për plotësimin, tërësisht ose pjesërisht, të kërkesave të tyre për energji elektrike, të cilët do të jenë të lidhur me sistemin trajtohen si më poshtë:

Në rastet kur ekziston kapaciteti i mjaftueshëm dispeçerues, Rregullat e Tregut dhe Kodi i Transmetimit mund të sigurojnë akses në rrjet për këtë tepricë dhe ERE-ja mund të përcaktojë tarifa për blerjen e kësaj energjie që krijon përfitim për klientet.

ERE-ja gjithashtu mund të përcaktojë pagesa përkatëse për kapacitet për të mënjeluar që një klient i tillë të lejohet të shkarkojë kosto mbi Klientët Tariforë. Nëse vetprodhuesi është në pjesën më të madhe të kohës "jashtë sistemit", por dëshiron ta përdorë sistemin si rezervë të njësisë vetë-prodhuese në rast të mirëmbajtjes ose defektit, Rregullat e Tregut mund të specifikojnë një tarifë "stand by", e cila duhet të miratohet nga ERE-ja.

d) Në mënyrë që tregu të arrijë objektivat e tij, ERE-ja dhe, në shumë raste OST-ja,

duhet të kenë akses të mjaftueshëm në informacionin lidhur me operimet, kostot, si dhe termat dhe kushtet e kontratave ndërmjet palëve. Për këtë arsye, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të dokumenteve ERE-ja duhet të sigurojë që të gjithë pjesëmarrësve të tregut do t'u kërkohej të japin të gjithë informacionin që kërkohej për kryerjen me sukses të funksioneve të ERE-s dhe OST-së, në mënyrë periodike, të plotë dhe të saktë, me kushtin e mbrojtjes së duhur nga nxjerrja e informacionit të ndjeshëm nga pikpamja e konkurrencës. Ky informacion duhet të përfshijë të paktën disponibilitetin e njësive gjeneruese dhe përdorimin aktual, disponibilitetin e transmetimit dhe përdorimin aktual, si dhe të dhëna të tjera lidhur me prodhimin dhe çmimet. Informacioni duhet të publikohet në faqet elektronike të ERE-s dhe OST-se, për aq sa ai do të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse të konfidencialitetit.

e) Për aq sa e lejojnë rrethanat, ERE-ja duhet të rrisë efektivitetin e shfrytëzimit të sistemit elektroenergjitik nepermjet aplikimit të një sistemi tarifor të energjisë elektrike për Klientët Tarifore, e cila nxit përdorimin e energjisë elektrike natën, dekurajon përdorimin e energjisë elektrike në orët e pikut, dhe inkurajon Klientët Tarifore për zvogelimin e kapacitetit.

f) ERE-ja miraton marrëveshjet e negociuara nga palët ku ndër të tjera do të përfshihen kontratat e mëposhtme:

- Marrëveshja një vjeçare ndërmjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe KESH Gen-it për energjinë elektrike, përfshirë çmimin, për orë dhe sezon, për çdo njësi përkatëse gjeneruese. Marrëveshjet mund të specifikojnë gjithashtu energjinë dhe kapacitetin neto vjetor që do të jetë i sigurtë ("must-run").

- Marrëveshjet dypalëshe afatgjata ndërmjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe çdo PPE-je për energjinë dhe kapacitetin neto, përfshirë çmimin për çdo orë dhe sezon.

- Marrëveshjet dypalëshe afatgjata (një vjeçare ose më shumë) ndërmjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe çdo PVE-je (Gjeneruesit e Shpërndarjes) për energjinë dhe kapacitetin neto, të cilat mund të përfshijnë çmimin për çdo orë dhe sezon.

- Marrëveshjen një vjeçare ndërmjet OST-se dhe KESH Gen-it për energjinë për të mbuluar humbjet në transmetim dhe shërbimet ndihmëse.

- Marrëveshjet ndërmjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice për energjinë elektrike të destinuar për furnizimin e klienteve tarifore.

g) ERE-ja miraton modele marrëveshjes ose kontratash për një numër kontratash ndërmjet pjesëmarrësve të tregut përfshirë:

- Marrëveshjet dypalëshe për shërbimin e Shpërndarjes ndërmjet OSSH-se dhe përdoruesve të sistemit të Shpërndarjes.

- Marrëveshjet e shërbimit të transmetimit midis OST dhe përdoruesve të sistemit të transmetimit.

h. Disbalancat

Shërbimi i Disbalancës së Energjisë sigurohet kur ka një diferencë ndërmjet sasisë së prodhimit që është programuar një ditë më parë ose që është prodhuar në kohë reale dhe të konsumit (ngarkesës) në kohë reale. Ai përfshin devijimet nga programet e transaksioneve dypalëshe. Ai mbulon gjithashtu flukset e paparashikuara të energjisë në sistem (për shembull nga sistemet jashtë Shqipërisë). Përdoruesi i transmetimit nuk e zgjidhin çështjen e disbalancimit nëpërmjet blerjeve të tyre, OST-ja do të bëjë blerjet e nevojshme për të siguruar që sistemi të mbetet i balancuar.

Disbalanca e Gjenerimit është diferenca ndërmjet sasisë së energjisë elektrike të programuar për çdo orë, dhe sasisë së energjisë elektrike të dhënë nga një burim gjenerues.

Shërbimi i Disbalancës së Gjenerimit merret kur ka një diferencë ndërmjet energjisë së programuar dhe asaj aktuale të livruar nga një burim gjenerues.

Në përcaktimin e tarifave për shërbimet e energjisë balancuese (si pjesë e sigurimit të shërbimeve ndihmëse), OST-ja do të sigurojë që njesitë që krijojnë disbalancën vlerësohen me koston e plotë të korrigjimit të disbalancës (përfshirë koston e energjisë së blerë nga OST-ja

per te balancuar sistemin). Këto tarifa do te jene jo-diskriminuese dhe te bazuara ne kosto. OST-ja, gjithashtu mund te vendose me miratimin e ERE-s pagesa shtese nepermjet ndeshkimeve per devijime te perseritura te konsiderueshme nga parashikimet. Cdo e ardhur e tepert e mbledhur nga OST-ja, nga te ardhurat e kerkuara per te paguar detyrimet e shërbimeve ndihmese te saj, duhet t'u kthehen ne fund te cdo muaji pjestareve te tregut ne mënyrë proporcionale.

i) Përmbushja e plotë nga të gjithë pjesmarrësit e tregut të detyrimeve të tyre kontraktuale dhe të tarifave, përfshirë pagesën e plotë për energji dhe shërbime të tjera, është e rëndësishme për suksesin e Modelit Shqiptar të Tregut. Megjithatë, mund të ketë raste, veçanërisht gjatë kohës që tregu maturohet, kur nuk do të bëhet pagesa e plotë. ERE-ja në bashkëpunim me OST-në dhe pjestarët e tregut duhet të përgatisë rregulla dhe kontrata model që rregullojnë çështjen e mos-pagesave apo pagesat e pjesshme. Nder te tjera, ERE-ja duhet të hartojë rregulla dhe procedura për të siguruar që autoriteti i saj rregullues ndaj Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice të ushtrohet sipas protokollit të likujdimeve dhe te kete mundesine te ndjekë fluksin e fondeve brenda Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice.

8. Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë Elektrike

Qeveria Shqiptare inkurajon investimet private per ndertimin e centraleve te rinj elektrik per te plotesuar kerkesat e vendit me energji elektrike dhe per te garantuar siguri te lartë furnizimi nepermjet diversifikimit te burimeve te gjenerimit.

ERE-ja ka autoritetin te kufizojë zgjatjen e afatit te marreveshjeve afatgjata ndermjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe PPE-ve apo furnizuesve te tjere per te shmangur efektet bllokuese ne zhvillimin e tregut per shkak te këtyre marreveshjeve.

Marreveshjet afatgjata që kanë të bëjnë me luhatjet ne çmimet e lëndës djegëse dhe në këmbimin valutor, duhen kufizur sa më shumë që të jetë e mundur.

Per te maksimizuar investimet private ne vend dhe per te zvogeluar efektet perjashtuese ne treg, rekomandohet qe Furnizuesi Publik me Shumice te bleje nga PPE-te vetem nje pjesë te prodhimit te tyre ndersa pjesa tjeter te lihet e lirë per t'u tregtuar me cmime te parregulluara brenda ose jashte vendit.

9. Procesi i Likujdimeve

Detajet e Proçesit të Likujdimeve do të specifikohen në Protokollin e Likujdimeve, si pjesë e Rregullave të Tregut të miratuara nga ERE-ja. Fondet e likujdimit duhet të perdoren sipas destinacionit per te shmangur devijimet e tyre. Proçesi duhet planifikuar që të funksionojë në mënyrë transparente, të mirëpresë përdorimin e marreveshjeve dypalëshe dhe të lehtësoje përmirësimin e nivelit të arkëttimeve.

ERE-ja ka autoritet te plote te siguroje qe veprimtarite e paleve jane kryer sipas rregullave dhe protokollove dhe se këto transaksione financiare jane plotesisht transparente dhe të auditueshme.

Modeli i Tregut reflekton përpjekjet për të minimizuar rriskun e manipulimit te tregut, duke i dhënë në këtë mënyrë shitësit në treg siguri të lartë për funksionimin e tregut. Lidhjet kontraktuale mes pjesmarresve te tregut janë përcaktuar qartë.

Furnizuesi Pulik me Shumice do të kompensojë OST-në vetëm për shërbimet e kryera prej saj dhe do të paguajë direkt Shitësin (mund të jetë KESH Gen-i, PPE-të, Furnizuesit e Kualifikuar etj.) për kostot e energjisë elektrike në përputhje me deklaratat (pasqyrat) fizike e dërguara nga OST-ja tek Furnizuesi Publik me Shumice.

Per te rritur besimin e shitesit qe pagesat do te kryhen, duhet qe:

Per tregun e rregulluar pagesat te behen direkt nga Furnizuesi Publik me Pakice, i cili është me afer burimit te fondeve per Furnizuesin Publik me Shumice, OSSH-ne dhe OST-ne;

te mos lejohet transferimi i parave cash nga Furnizuesi Publik me Pakice tek OST-ja me qellim pagimin e shitesve te tjere;

marreveshjet dhe modelet e marreveshjeve te rregulluara miratohen nga ERE-ja.

Shtojca E

Detyrat Kryesore që kërkohen për zbatimin e Modelit Shqiptar të Tregut

Institucionet dhe entet përgjegjëse të përcaktuara ne kete model tregu do te marrin masa per zbatimin ne përgjithësi te ketij modeli dhe në vecanti për:

Rishikimin dhe harmonizimin e akteve ligjore në fuqi;

Rishikimin dhe harmonizimin e Rregullave të Tregut;

Rishikimin dhe harmonizimin e Kodit të Shpërndarjes;

Rishikimin dhe harmonizimin e Kodit të Transmetimit;

Përgatitjen dhe miratimin e kontratave tip për transaksionet ndërmjet pjesmarrësve të tregut (vecanerisht per tregun e rregulluar);

Përgatitjen e rregullave dhe Protokollit te Likuidimeve për të rregulluar çështjet e mos-pagesave ose pagesave të pjesshme nga pjesmarrësit e tregut;

Pershpejtimin e reformës per ristrukturimin dhe ndarjen e veprimtarive ne sektorin elektroenergjetik;

Instalimin e matjes së duhur për të siguruar informacion të qëndrueshëm rreth të gjitha transaksioneve;

Zhvillimin dhe zbatimin e standarteve të kontabilitetit;

Përgatitjen dhe zbatimin e protokolleve të fluksit të informacionit;


Instalimin e teknologjive të informacionit që kërkohen për informacion të sigurtë të tregut;

Zhvillimin dhe miratimin e tarifave të bazuara në kosto për shërbimet e transmetimit dhe shpërndarjes.

STRUKTURA E TREGUT

FLUKSI I ENERGJISË ELEKTRIKE


SHTOJCA “A”




STRUKTURA E TREGUT

SHTOJCA “ B “

MARRËVESHJET E LIDHJES DHE TË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT PËRFSHIRË SHËRBIMET NDIHMËSE (të siguruar nga OST)




Shënim 1 : Klientët e Kualifikuar , të lidhur me Sistemin e Shpërndarjes , do të duhet të lidhin një marrëveshje me OSSH , që i shërben atyre , lidhur me lidhjen dhe shërbimet e Shpërndarjes.



STRUKTURA E TREGUT

LIKUIDIMET – FLUKSI I FONDEVE

SHTOJCA “ D “



Shënim 1 : Pagesa sipas Marrëveshjes Vjetore të Rregulluar të Furnizimit me Energji , të blerë jashtë kontratave.

Shënim 2 : Pagesa sipas Tarifës së Përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes

